**VENDIM**
**Nr.281, datë 7.4.2020**

# PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS PËR KALIMIN E PRONËS SHTETËRORE NË PRONË PRIVATE, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI SHITËS, DHE SHOQËRISË "LION CONSTRUCTION", SH.P.K., SI BLERËS, PËR PASURITË SHTETËRORE NR.6/76 DHE NR.6/187, NË FUNKSION TË PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim, të vendimit nr.807, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si shitës, dhe shoqërisë "LION CONSTRUCTION", sh.p.k., si blerës, për pasuritë shtetërore nr.6/76, me sipërfaqe 205 m2, dhe nr.6/187, me sipërfaqe 85 m2, në funksion të planeve të përgjithshme vendore, sipas genplanit dhe tekstit të projektkontratës që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

# GENPLAN I PRONAVE, TIRANE




## SIPERFAQET

- 6/130 SIPERFAQJA S=480m²
- 6/76 SIPERF
- 6/451 SIPERFAQJA S=2170m²
- 6/187 SIPER

Shkalla 1:500






KUFITARET

VERI 6/452

JUG 6/167,6/188

LINDJE 6/77,6/170

PERENDIM RRUGE

LEGJENDA

— KUFIRI I PRONES

PRONA SHTET

PRONA PRIVATE

...AQJA S=224−19=205m²

...AQJA S=114−29=85m²

KONFIRMOI

PERFAQESUESI I
PREFEKTIT QARKUT
TIRANE:

Alfred Skapi

PERFAQESUESI I ASHK
DREJTORIA VENDORE
TIRANE:

Naime Zoporça

PERFAQESUESI I MFE
DREJTORI I DREJTORISE
PRONAVE PUBLIKE:

Ildiv Xhoxhi

BLERESI:

LION CONSTRUCTION L 62309009 J

Ing.Margarit STAVRI

Lic N.1188/1 Date 29.05.2017

MARGARIT STAVRI Ing Gjeodet